REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA MITROVICA E VERIUT · OPŠTINA SEVERNA MITROVICA
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY
01 01-030/01-0025020/24
1 24/04/2024

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
## Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

**Kryetari i Komunës.**
**Nr.______________. Data: 24/04/2024.**
**Mitrovicë Veriore.**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Ligjit Nr. 08/L-197 si dhe Rregullores Nr. 01/2024 për Disiplinën e Nëpunësve Civil, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

## V E N D I M
**(Për formimin e Komisionit Disiplinor)**

1. **Formohet** Komisioni Disiplinor në përbërje prej:

   1.1. znj. Aida Sejdiu – kryesuese;
   1.2. z. Hamit Mripa – anëtar;
   1.3. znj. Lirije Fejza – anëtare.

2. Komisioni Disiplinor obligohet të bëjë trajtimin e lëndëve në rastet e zyrtarëve ku pretendohet për shkelje të detyrave dhe përgjegjësive, në rastet kur nuk kryen detyrat që i janë dhënë, kur bën zbatim jo të duhur të tyre, apo kur gjatë ushtrimit të tyre vepron në kundërshtim me Kushtetutën, ligjet dhe akte të tjera nënligjore në fuqi. Shkelja disiplinore mund të bëhet me veprim apo mosveprim, dhe në bazë të fakteve dhe provave të shqipton masë disiplinore.

3. Njësia e Burimeve Njerëzore i ofron ndihmë administrative Komisionit për zhvillimin e procedurës disiplinore.

4. Mandati i Komisionit është dy (2) vjeçar.

5. Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi, anulohet **Vendimi Nr. 01-651/031 i datës 25.07.2023** si dhe **Vendimi Nr. 01-815/031 i datës 24.10.2023.**

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E MITROVICËS E VERIUT / OPŠTINA SEVERNA MITROVICA / MITROVICA NORTH MUNICIPALITY

**Erden ATIQ**
______________________
**Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore**

**Shtojcë:**
Vendimi Nr. 01-651/031 i datës 25.07.2023;
Vendimi Nr. 01-815/031 i datës 24.10.2023.



**I dorëzohet:**
1x1 Kryetarit
1x1 Zyrës ligjore
1x1 Zyrës së Informimit
1x1 Anëtarëve të Komisionit
1x1 Arkivit

**Republika e Kosovës**

Republika Kosova – Republic of Kosovo

**Komuna e Mitrovicës Veriore**

Opština Mitrovica Sever – Municipality of Mitrovica North

Duke u bazuar në Nenin 58 nën b) të Ligjit Nr.03/L – 040 Për Vetqeverisjen Lokale, Nenin 49 të Ligjit Nr.06/L – 114 Për Zyrtarët Publik dhe Nenin 10 paragrafi 1.2 dhe 3 te Rregullores (QRK) Nr 11/2020 per disiplinën dhe ankesat e zyrtarve publik, Erden Atiq kryetari i komunes se Mitrovices se Veriut ,miraton këte:

VENDIM
Për themelimin e komisionit disiplinor

1. Themelohet komisioni disiplinor në përbërje:

   - Xhevdet Haxhiu, Kryesues i komisionit- nëpunës civil i nivelit drejtues
   - Aida Sejdiu, Antare i komisionit –nëpunës civil i nivelit profesional
   - Lirije Fejza Antare i komisionit –nëpunës civil i njësis së burimeve njerzore.

2. Mandati i komisionit eshte tre (3) vjecar.

3. Komisioni disiplinor ka keto kompetenca:
   - Bënë shqyrtimin e fakteve dhe provave te paraqitura
   - Përcakton dhe shqipton masën disiplinore.

4. Njësia e burimeve njerzore i ofron ndihmë administrative Komisionit rreth zhvillimit te procedures disiplinore.

Vendimi i dërgohet:

1 x Kryetarit të komunës
1 x Arkivit të komunës
1 x Udhëheqësit të njësis së personelit
1 x secilit anëtar të komisionit

Erden Atiq

Kryetari i Komunës

Data:24.07.2023

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA MITROVICA E VERIUT OPŠTINA SEVERNA MITROVICA
MITROVICA NORTH MUNICIPALITY

Njesia Org. / Org. Jedin. / Org. Unit: 01 — Nr.Prot. / Br.Prot. / Prot.Nr.: 815-031
Nr. i faqeve / Br. stranica / No pages: 01 — Data / Datum / Date: 24.10.23

# Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
## Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Severna Mitrovica – Municipality of Mitrovica North

**Kryetari i Komunës**
**Nr.______________. Data: 24.10.2023.**
**Mitrovicë Veriore.**

Bazuar në nenet 13 dhe 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014 si dhe Ligjit për Zyrtarët Publik, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

**V E N D I M**
**(Për Plotësim-Ndryshimin e Vendimit Nr. 01-651/031 i datës 25.07.2023)**

1. Ndryshohet Pika 1 e Vendimit Nr. 01-651/031 i datës 25.07.2023, si në vijim:

   1.1 Kryesuesi i Komisionit, z. Xhevdet Haxhiu, zëvendësohet nga znj. Fatime Stavileci.

2. Dispozitat tjera të Vendimit 01-651/031 i datës: 25.07.2023 mbesin në fuqi.

3. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

**A R S Y E T I M**

Për shkak të pezullimit nga puna të zyrtarit z. Xhevdet Haxhiu, sipas Vendimit **Nr. 01/810-031** i datës **20.10.2023**, i njëjti në komisionin disiplinor zëvendësohet nga znj. Fatime Stavileci, Ushtruese Detyre e Udhëheqësit në Zyrën e Gjendjës Civile, sipas Vendimit **Nr. 01/811-031** i datës **20.10.2023.**

**Kryetari i Komunës**

**Erden ATIQ**



**I dorëzohet:**
1x1 Kryetarit
1x1 Zyrës ligjore
1x1 Zyrës së Personelit
1x1 Anetareve te komisionit
1x1 Arkivit